



Tiranë më

Nr.

RELACION
PËR
PROJEKTVENDIMIN
PËR

**NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 10, DATË 23.10.2024, TË KOMISIONIT
RREGULLATOR “PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE PËR REGJISTRIMIN E
ZGJEDHËSVE NGA JASHTË TERRITORIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
DHE PËRGATITJEN E LISTËS SË ZGJEDHËSVE”, TË NDRYSHUAR**

**I. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN
NË FUQI**

Në mbështetje të nenit 20, pika 1, shkronja “dh”, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, përcaktohet kompetenca e Komisionit Rregullator për të shqyrtuar dhe miratuar projektaktet me karakter normativ, të përgatitura nga administrata e KQZ-së ose nga anëtarët e tij, për rregullat për regjistrimin e votuesve nga jashtë vendit, për procedurat e tyre të votimit, për administrimin dhe numërimin e votave nga jashtë vendit dhe përfshirjen e tyre në rezultatin e përgjithshëm të zgjedhjeve për Kuvendin.

Neni 25, pika 8 përcakton se, zgjedhësi që ka paraqitur kërkesë në listën e zgjedhësve që votojnë nga jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë vëren se nuk është i regjistruar në këtë listë ose regjistrimi i tij ka pasaktësi, ai ka të drejtë të paraqesë kërkesë në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë deri 30 ditë përpara datës së zgjedhjeve. Kërkesa mund të paraqitet edhe online nëpërmjet një platforme elektronike të miratuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor. Kërkesa sipas kësaj pike përjashtohet nga taksa gjyqësore. Gjykata shqyrton dhe vendos për kërkesën, sipas kësaj pike, nëpërmjet kësaj platforme brenda 48 orëve nga data e regjistrimit të kërkesës. Emrit dhe të dhënave të tjera të zgjedhësit, që i shtohen listës së zgjedhësve që votojnë nga jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, i bashkëngjitet vendimi i Gjykatës.

Duke vlerësuar nga pikëpamja e objektit që trajton ky projektvendim, vlerësohet nga ana e ligjshmërisë se është në kompetencë të Komisionit Rregullator për ta shqyrtuar.

II. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTVENDIMIT

Në datën 23.10.2024, Komisioni Rregullator miratoi vendimin “Për miratimin e rregullave për regjistrimin e zgjedhësve nga jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë dhe përgatitjen e listës së zgjedhësve”, me qëllim përgatitjen e kushteve dhe zbatimin e masave që mundësojnë votimin nga jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë për zgjedhjet për Kuvend, me qëllim garantimin e të drejtës së votës të çdo shtetasi shqiptar që ndodhet jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë në datën e zgjedhjeve.

Me miratimin e ligjit nr. 10/2025, Kuvendi bëri disa ndryshime dhe shtesa në Kodin Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë. Një nga këto ndryshime prek pikën 8 të nenit 25 të Kodit Zgjedhor, e cila lidhet me paraqitjen e kërkesës në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë deri 30 ditë përpara datës së zgjedhjeve. Kërkesa mund të paraqitet edhe *online* nëpërmjet një platforme elektronike të miratuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor. Kërkesa sipas kësaj pike përjashtohet nga taksa gjyqësore. Gjykata shqyrton dhe vendos për kërkesën, sipas kësaj pike, nëpërmjet kësaj platforme.

Referuar këtij ndryshimi, lind nevoja për saktësimin e vendimit nr. 10, datë 23.10.2024 “Për miratimin e rregullave për regjistrimin e zgjedhësve nga jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë dhe përgatitjen e listës së zgjedhësve”.

Për sa më lart në këtë relacion, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, brenda kompetencave të veta, dhe në respektim të detyrimeve e afateve ligjore të përcaktuara në ligjin nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, i propozon për shqyrtim dhe miratim Komisionit Rregullator projektvendimin “Për një ndryshim në vendimin nr. 10, datë 23.10.2024, të Komisionit Rregullator “Për miratimin e rregullave për regjistrimin e zgjedhësve nga jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë dhe përgatitjen e listës së zgjedhësve”, të ndryshuar”.

Jona JOSIFI

- Drejtorja e Votimit nga Jashtë

Pavlina DOÇAJ

- Drejtorja e Ligjshmërisë

Majlinda ÇELMETA

- Sekretar i Përgjithshëm (në mungesë dhe me urdhër)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONI RREGULLATOR

Tiranë më

Nr.

Data:

Nr:

Ora:

VENDIM

PËR

NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 10, DATË 23.10.2024, TË KOMISIONIT RREGULLATOR “PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE PËR REGJISTRIMIN E ZGJEDHËSVE NGA JASHTË TERRITORIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE PËRGATITJEN E LISTËS SË ZGJEDHËSVE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 20, pika 1, shkronja “dh”, dhe nenit 25, pika 8, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, Komisioni Rregullator

V E N D O S I:

- I. Në vendimin nr. 10, datë 23.10.2024, të Komisionit Rregullator “Për miratimin e rregullave për regjistrimin e zgjedhësve nga jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë dhe përgatitjen e listës së zgjedhësve”, të ndryshuar, bëhet ky ndryshim:
- Pika 13 e Kreut V ndryshohet si më poshtë vijon:

“13. Kur zgjedhësi që ka paraqitur kërkesë në listën e zgjedhësve që votojnë nga jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë vëren se nuk është i regjistruar në këtë listë ose regjistrimi i tij ka pasaktësi, ai ka të drejtë të paraqesë kërkesë në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë deri 30 ditë përpara datës së zgjedhjeve. Kërkesa mund të paraqitet edhe *online* nëpërmjet një platforme elektronike të miratuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor. Kërkesa sipas kësaj pike përjashtohet nga taksa gjyqësore. Gjykata shqyrton dhe vendos për kërkesën, sipas kësaj pike, nëpërmjet kësaj platforme brenda 48 orëve nga data e regjistrimit të kërkesës. Emrit dhe të dhënave të tjera të zgjedhësit, që i shtohen listës së zgjedhësve që votojnë nga jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, i bashkëngjitet vendimi i Gjykatës.”

Data: 2025 Nr:

Ora:



“Për një ndryshim në vendimin nr. 10, datë 23.10.2024, të Komisionit Rregullator “Për miratimin e rregullave për regjistrimin e zgjedhësve nga jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë dhe përgatitjen e listës së zgjedhësve”, të ndryshuar”

